POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1

Të shtrirë e të mbuluar në gjak si viktimat e Buchës, një grup njerëzish në Pragë kujtojnë jetët e humbura në Ukrainë

2

Zbulohet ferma në Paraguaj ku u gatua Fake News për Enkelejd Alibeajn nga diplomati veteriner dhe një gazetar lopësh, Peter Tase pika lidhëse me Berishën

3

Mero Baze: Për kë bien kambanat e sanksioneve financiare të SHBA?

4

61-vjeçari vrau bashkëjetuesen e djalit, gruaja duke larë gjakun e të resë: E acaronte, i thoshte dil nga shtëpia se është e imja

5

Mbollën parcelën me kanabis dhe 'blinduan' pyllin me granata e kamera sigurie, në pranga trafikanti (VIDEO)

Kronikë

Atentat në Shkodër, ekzekutohet Nazim Bandula i përfshirë në trafikun e drogës, armëve e prostitucionit! Në vitin 2000 bashkë me vëllanë u përfshinë në një vrasje, 3 vite më pas iu bë atentat

Ekzekutohet me breshëri kallashnikovi Nazim Bandula në Shkodër. Ai ishte një person me precedent të mëparshme penal, ku në 2012 kërcënoi me armë të vëllanë për konflikte pronësie, ndërsa në 2020, Bandulës iu vendos tritol në mjetin e tij.

■ Vrasja e Nazim Bandulës, 55-vjeçari u qëllua 13 herë, 6 plumba e kapën në trup! Asnjë gëzhojë në vendin e ngjarjes, autorët u larguan me 'Benz'
■ Shenja gjaku në trotuar, ja ku u qëllua për vdekje Nazim Bandula teksa po pinte kafen para banesës (VIDEO)
■ Vrasja në Shkodër, Nazim Bandula në 2012 kërcënoi me armë vëllanë për konflikte prone, në 2020 i vunë tritol në makinë

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

Redaksia
12 Prill, 08:29 | Përditesimi i fundit: 12 Prill, 15:06

SHKODËR-Nazim Bandula kur kishte dalë nga shtëpia e tij për të konsumuar kafen e mëngjesit nuk e kishte menduar se ajo do të ishte e fundit. Teksa qëndronte i vetëm në lokalin pranë banesës së tij në lagjen 'Partizani' në Shkodër, 55-vjeçari është qëlluar me breshëri kallashnikovi nga një mjet në lëvizje. Bandula ngeli i vdekur në vend, ndërsa në vendin e ngjarjes mbetën pas vetëm njollat e gjakut. Ndaj tij u qëllua 13 herë, nga të cilat 6 prej plumbave e kanë prekur në pjesën e sipërme të trupit. Autorët po lëviznin me një mjet tip Mercedez Benz me ngjyrë të bardhë dhe xhama të zinj duke zbrazur kallashnikovin në drejtim të 55-vjeçarit. Ata janë siguruar që të mos lënë asnjë gjurmë në vendin e ngjarjes pasi të gjitha gëzhojat kanë rënë brenda mjetit të tyre. Atentati është filmuar nga një kamera sigurie në distancë, e cila nuk ka ndihmuar shumë hetuesit për zbulimin e autorëve.

55-vjeçari nuk ishte një emër i panjohur për policinë, ndërsa në pistat e hetimit janë të shumta për shkak të së kaluarës së 55-vjeçarit në aktivitete kriminale Në të shkuarën Bandula ka qenë i përfshirë në trafik narkotikësh, trafik armësh dhe prostitucion. Po ashtu, hetuesit nuk përjashtojnë edhe pistën e hakmarrjes, pasi në vitet 2000 Nazim Bandula bashkë me të vëllanë Albanin ka qenë i përfshirë në një vrasje pranë kinemasë në Shkodër për shkak të një vajze. Tre vite pas kësaj ngjarje Nazim Bandulës i është bërë atentat në aftësi të Bushatit.

LEXO EDHE:
I vihet flaka makinës së kryeplakut të Vermoshit në Malësi të Madhe, Prek Vata: I kishin hedhur benzinë

Gjithashtu më ***26 dhjetor të 2020***, një sasi tritoli i ishte vënë mjetit tip fouristradë X5, të Bandulës që ishte i parkuar pranë shtëpisë së tij, ku nga shpërthimi nuk pati të lënduar. Vetë Bandula tha për ngjarjen në atë kohë se nuk e kishte idenë se kush ia kishte vendosur tritolin, pasi nuk kishte konflikte. Në 2012 ai ishte arrestuar pas një konflikti pronësie me vëllanë e tij, të cilin e kishte kërcënuar me armën.

Bandula jetonte mes Shkodrës dhe Elbasanit dhe nuk ruhej dhe lëvizte lirshëm edhe pse kishte konflikte të shumta për shkak të kaluarës së tij.

[Shqiptarja.com]

Viktima Nazim Bandula

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 12:02

Kush është Nazim Bandula që u ekzekutua sot në Shkodër

Viktima Nazim Bandula

Report Tv ka siguruar fiton e viktimës Nazim Bandula që u ekzekutua mëngjesin e sotëm në Shkodër. Në foto ai është në një moshë të re dhe sot që ishte 55 vjeç.

Ora 11:50

Vrasja e Nazim Bandulës, 55-vjeçari u qëllua 13 herë, 6 plumba e kapën në trup! Asnjë gëzhojë në vendin e ngjarjes, autorët u larguan me 'Benz'

Të tjera detaje janë zbardhur në lidhje me ekzekutimin sot në Shkodër të 55-vjeçarin Nazim Bandulës. Bëhet me dije se autorët kanë përdorur një automjet tip Mercedez Benz me ngjyrë të bardhë me xhama të zinj, ndërsa të gjitha gëzhojat kanë mbajtur në makinë pasi hetuesit nuk kanë gjetur asnjë në vendin e ngjarjes. Në drejtim të viktimës është qëlluar 13 herë, ku 6 plumba e kanë prekur në pjesën e sipërme të trupit, çka i shkaktuan vdekjen e menjëhershme. Skena është filmuar nga një kamera sigurie në distancë, e cila nuk ka ndihmuar shumë hetuesit.

Ora 11:46

Atentati në Shkodër, viktima i përfshirë në trafikun e drogës, armëve dhe prostitucionit! Në 2000 së bashku me vëllanë janë përfshirë në një vrasje, 3 vite më pas iu bë një atentat

Detaje të reja nga atentati ndaj Nazmi Bandulës në lagjen "Partizani" në Shkodër. Burime nga grupi hetimor bëjnë me dije se akoma nuk ka asnjë gjurmë të autorëve të ngjarjes. Pistat e hetimit janë të shumta për shkak të së kaluarës së 55-vjeçarit në aktivitete kriminale. Në të shkuarën Bandula ka qenë i përfshirë në trafik narkotikësh, trafik armësh dhe prostitucion. Po ashtu, hetuesit nuk përjashtojnë edhe pistën e hakmarrjes, pasi në vitet 2000 Nazmi Bandula bashkë me të vëllanë Albanin, janë të përfshirë në një vrasje për një vajzë pranë kinemasë në Shkodër. Tre vite pas kësaj ngjarje Nazmi Bandulës i është bërë atentat në aftësi të Bushatit. Bandula jetonte mes Shkodrës dhe Elbasanit, ndërsa edhe pse ishte i njohur për konflikte të së shkuarës, nuk ruhej asnjëherë dhe lëvizte lirshëm.

Ora 09:23

Prostitucion dhe vrasje, ja e shkuara e Nazim Bandulës që u ekzekutua me breshëri kallashnikovi në Shkodër

Nazim Bandula i cili u ekzekutua mëngjesin e sotëm pranë banesës së tij dyshohet si se ishte një trafikant i vajzash me qëllim prostitucionin. Sipas informacioneve të siguruara ai dyshohet se është përfshirë më parë në ngjaje të tjera kriminale, si vrasje.

Ora 08:52

Shenja gjaku në trotuar, ja ku u qëllua për vdekje Nazim Bandula teksa po pinte kafen para banesës (VIDEO)

Report Tv mëson se Nazim Bandula është qëlluar nga një mjet në lëvizje teksa po pinte kafe para banesës së tij.

Në videon e siguruara, shihet shenjat e gjakut në trotuarin ku ra i vdekur Bandula.

Ora 08:45

Vrasja në Shkodër, Nazim Bandula në 2012 kërcënoi me armë vëllanë për konflikte prone, në 2020 i vunë tritol në makinë

Nazim Bandulës, i cili u vra mëngjesin e sotëm me armë zjarri pranë shtëpisë së tij 1 vit e gjysmë më parë i kishim vendosur tritol në makinën e tij të parkuar në oborrin e tij në lagjen Partizani, në Shkodër. Ngjarja është regjistruar më 26 dhjetor të vitit 2020.

Pas hetimeve të kryera rezultoi se ***Banudula*** ishte një person me precedentë të mëparshëm penalë, për konflikte brenda familjes, ku në 2012 ishte arrestuar pas një konflikti pronësie me vëllanë e tij, të cilit e kishte kërcënuar me armën.

I.K./r.k./Shqiptarja.com

TAG: vrasje me armë zjarri Shkoder Nazim Bandula vrasja e nazim bandules

Komento

Komente

refugjati: 12/04/2022 18:54

nuk i urohet vdekja askujt por nqs ka bere krime daguash para Zotit ....kur te shkosh vet ose kur ta presin bileten e takimit te tjeret urime atyre qe qelluan qe ja arriten ti jepnin bileten atij dhe nuk bene viktima deri sa te vriten ndermjet tyre e pa bere viktima te pa fajshem esht nje fitim per shoqerine e sado pak lehtesi per viktimat qe ata kane bere kot nuk i thone qe nuk te vret njeri kot Shkodra neser do zgjohet me nje m.t me pak

Përgjigju

AltinTop: 12/04/2022 18:40

Kemi 10 vite me Ramen KM dhe akoma e ka fajin Saliu... Ktu jemi me keq se ne Rusi me propaganden..

Përgjigju

vlora1: 12/04/2022 16:34

Mbuloi balta balten

Përgjigju

Mali me gropa: 12/04/2022 13:04

Ja dhe pranvera erdhi ne Albanistan .

Përgjigju

Tironsi: 12/04/2022 12:20

Shkodra udheheq hahaha e kan shenjestren shume te sakt jo si Vlonjatet qe kan gabuar shume kohet e fundit le pastaj Elbasani qe i ka humbur shenjestra komplet. ????????????????

Përgjigju

> **shqiptari:** 12/04/2022 18:49
>
> me pelqen komenti jot o tironso. shyqyr qe vriten me njeri tjetrin e nuk bejne viktima te pa fajshme

Djal: 12/04/2022 17:57

Hhahahahahah ca elbasani hahahah elbasani vetem frate ka or shok hahahah femnat i ka tmira

Vlora: 12/04/2022 14:37

Ahahahha oree do e degjoni dhe vloren po prisni ju e dini qe ne kemi surpriza

Vlonjati: 12/04/2022 13:08

Ke te drejte në Vlorë e Elbasan duhet futur zbori dhe stërvitja ushatrake si lëndë mësimore...

INRI: 12/04/2022 12:10

Mbetje otomane qe e moren ne qafe jo vetem Shkodren por gjithe vatanin.

Përgjigju

Shoku: 12/04/2022 10:02

Pune fshataresh, ky duket qe e pinte kafen me liste, qe nga mbiemri duket fis kacakesh hajdute pulash qe ska lidhje me Shkodren.Sa per vrasjet ja kane vene ne kurriz kot se ne Shkoder i kane qejf legjendat urbane.

Përgjigju

Shoku: 12/04/2022 17:53

Edhe ti shoku tari si ky je Barbon qe mban listen e llafeve te pazarit me emer e mbiemer dhe qe mburresh me emra talibanesh koke palare, ik or bej ndonje leke per vete se vjen era djerse.

O shoku tari: 12/04/2022 14:34

Ku jeton qe ju thu fshatar e skan ber vrasje ? Ky ka ba 5 vrasje i din tan shkodra me emer e mbiemer e nje a kan lan ne karrik me rrota . Po ti je nej buzqumsht i vogel qe se njef nazin e alban bandulen

shkoder: 12/04/2022 12:42

Ska rendesi fisi kur behet fjale per jete njeriu . U gezofshim asnjehere për vdekjen e tjetrit ,mos ia uro askujt ate qe nuk do qe te te ndodhe ty

Beni: 12/04/2022 09:41

Nese jane marre me femra e ka hak vdekjen !

Përgjigju

jaku: 12/04/2022 09:33

Koken hangeshin me mjani tjetrin se kriminela jane.....

Përgjigju

Bajri: 12/04/2022 09:26

Karma quhet latinisht. Ky mori ate qe meritonte qe para 20 vitesh.

Përgjigju

shefi: 12/04/2022 18:48

jam dakort me ty o bravo...shpresojm sa me shpejt te gjith keta rrac derra qe kane para krimi

Bravo: 12/04/2022 09:37

Shum e ka shty , 20 vjet ka qe e meriton plumin me vrasjet qe ka ba dhe femrat qe ka cu ne rrug .
Edhe albani shum e ka shty e meriton nji tegel kallashi avash avash

Shkodran i vjeter: 12/04/2022 09:25

Nje kriminel me pak ne Shkoder. Po pastrohet vendi nga kriminelet. Bandulla ka shume krime mbi vete dhe mos ja fusni kot me sherret ne familje apo kercenimin ndaj vellait. Tek ky rendojne nje mori krimesh mostruoze te kryera nder vite. Gjithsesi ne nje menyre apo tjeter, heret a vone te gjithe do kene fundin e merituar. Mjere kush ka lyer duart me gjak.

Përgjigju

Andi: 12/04/2022 09:13

Keta kan dasht me ba emer tu u vra me njeni tjetrin konflikte mbrenda fisit kan pas gjithmone njerez kot

Përgjigju

Kirasi: 12/04/2022 09:07

Sa vrasje ka ba nazi e sa femra ka cu jashtetit me punu shum ka shty . Tesh edhe albani e ka radhen , smund ta kalojn kaq kollaj

Përgjigju

Kirasi: 12/04/2022 09:31

Po ke ka vra nazi ma vlla , ky vec me femna a marr ke ka gjet te urte se per tjer ska guxu, po albani me nazin jan ne konflikt me vite , taman thet andi keta jan gjujt e ngatrru vllau me vllan jan deng pa mark

Ju lumshin durt: 12/04/2022 08:50

Kaher e ke meritu si ti si albani shum e keni shty po qe ju erdhi dita me tan ato vrasje qe keni ba e femra qe keni cu jasht . Dhe albani shum shpejt ka me e hanger se ka te gjat

Përgjigju

Gjergji: 12/04/2022 08:44

O zot!!!!!Shpetoje Shkodren nga kto bandite qe erdhen ne Shkoder e shkaterruan ate,shpetoje nga ajo bande bandidesh qe drejtojne Shkodren per gjate 30 viteve.DJEGESI E SHKATRRIMTARI i Shkodres eshte sot kryetar Bashkije e eshte perkrahesi fanatik i armikut jo vetem te popullit te vet,eshte bandidi,hajduti,terroristi,vrasesi jo vetem i Shqiptareve.Ai bandit ka emrin Sali Berisha i shoallur "non grada" nga DASH.

Përgjigju

kastrioti: 12/04/2022 18:46

o gjergj ka 10 vjet rama ne qeverine qendrore por qeverine vendore e ka gjithmone non grata o shoku.nje drejtor policije vendos drejtori i pergjithshem i policise qe i jep llogari ministrit por policat nuk i vendos drejtori. nuk dua te hap polemika te kota por provoje ti kundervihesh kryetarit te bashkive....kush e di si shkon puna. ai spahija e non gratas dogji shkollat e akoma nuk ka paguar.non grata denonconte barajt qe ndihmojne ps ne zgjedjet e pergjithshme para 10 vjeteve kur vet bajri deklaroi qe ishte ne grupin e spahise rri o gjergj e numero kriminelet e vrare ndermjet tyre e uro qe te vazhdojne keshtu.deri sa te vriten me njeri tjetrin pa bere viktima te pa fajshme hallall

O Gjergj: 12/04/2022 14:27

Shkodra eshte mbushur me makina me xhama te zinj sterre, nje pjese e mire te perdorur nga kontigjentet e krimit. Makine e tille ishte edhe kjo me te cilen u krye krimi. Kush i lejon te livadhisin keto makina me potencial te larte kriminal, Saliu? Gazetari thot erdhi policia, rrethoi zonen e krimit, e terrci verrci. Ku eshte kjo polici kur u kalojne cdo dite para syve dhjetra makina me xhama te zinj sterre? Si qenka faji i Saliut? Tash 10 vite na drejton Edi. Si qenka faji i Saliut ore?

anna: 12/04/2022 10:19

Te lumte ajo goje e dore fiks ja ke thane

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

A mendoni se SHBA-të do vijojnë të ndëshkojnë politikanët e korruptuar?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Kronikë

Arrestohet pakistanezi në Shkodër bashkë me 6 shtetas të huaj, do t'i kalonte drejt Malit të Zi me destinacion drejt BE-së

10 Prill, 15:28

Kronikë

Zgjerohet harta e infektimit, konfirmohet edhe në Shkodër rasti i parë me gripin e shpendëve

7 Prill, 12:23

Kronikë

Tiranë/ Ekzekutohet me armë zjarri brenda makinës një 37-vjeçar pranë kthesës së Rinasit! Dera e pasagjerit u gjet e hapur, dyshime se shënjestra nuk ka udhëtuar i vetëm (VIDEO)

3 Prill, 22:44

Politikë

Basha nga Shkodra: Kur Berisha do marrë përgjegjësinë e të iki si unë? I fryn përçarjes dhe nxit dhunën për interesa familjare! Vendimi i gjykatës ilegjitim, PD s'bën para me 'Non Gratat'

3 Prill, 19:59

Kronikë

'Nuk bëj më shumë se 1 ditë burg po më denoncove'/ Dëshmia e plotë e Eljana Sherifit që u shfrytëzua nga tutori Luvigj Shpati, prokurorja Blerta Hamza e liroi për 2 ditë

Adriatik Doci

2 Prill, 20:19

Politikë

'Pse dhe si ndodhën vrasjet e 2 prillit 1991', flet për herë të parë ish-zv.ministri i Brendshëm! Çmontimi i një krimi të shumëfishtë shtetëror

2 Prill, 18:48

Kronikë

Plane për të shkuar në Theth? ARRSH jep lajmin e mirë: Qarkullimi kryhet pa probleme

2 Prill, 18:37

Politikë

Masakra e 2 prillit nëpërmjet FOTOGALERISË! Pamjet e rralla nga ngjarja që tronditi vendin

2 Prill, 15:48

Politikë

Berisha flet nga Shkodra si kreu i PD-së: Nuk votojmë kandidatin e Ramës për president! Alibeaj: Qëndrim personal, s'ka lidhje me grupin parlamentar të PD-së

2 Prill, 10:28

Kronikë



Falsifikonin dokumente mjekësore e shkollorë në këmbim të parave, 3 të arrestuar në Shkodër, 1 në hetim në gjendje të lirë

1 Prill, 09:45

Politikë

Ikën Voltana Ademi, Bardh Spahia merr zyrtarisht drejtimin e Bashkisë së Shkodrës

31 Mars, 18:08

Kronikë



Shkodër/ Po lëvizte i lirë në rrugë në mes të qytetit, kali tenton të kalojë rrugën, por përplaset me makinën (VIDEOLAJM)

31 Mars, 16:55

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje